Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 11 maj 2012

Lënda nr. 04/07

Kadri BALAJ (në emër të Mon BALAJ), Shaban XHELADINI (në emër të Arben XHELADINI), Zenel ZENELI dhe Mustafa NERJOVAJ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 11 maj 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pasi shqyrtoi ankesën e lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas diskutimeve, vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 11 tetor 2007 dhe është regjistruar në të njëjtën datë. Gjatë procedurës para Panelit, ankuesit janë përfaqësuar nga z. Halim Sylejmani,

avokat nga Kosova, dhe nga zotërinjtë Paul Troop dhe Jude Bunting, avokatë nga Londra.

2. Lidhur me procedurat deri në nxjerrjen e vendimit të Panelit, të datës 31 mars 2010, Paneli i referohet hapave proceduralë, të renditur në atë vendim (§§ 11-31). Në vijim janë ritheksuar vetëm hapat më të rëndësishëm, si dhe është dhënë shpjegimi përkitazi me hapat proceduralë, të ndërmarrë që nga nxjerrja e vendimit të lartpërmendur.

3. Më 6 qershor 2008, Paneli shpalli ankesën të pranueshme.

4. Më 19 mars 2009, u mbajt seanca e mbyllur. Në këtë seancë kanë marrë pjesë përfaqësuesit vijues të palëve:
   - Në emër të UNMIK-ut:
     - z. Ernst Tschoepke, ushtrues i detyrës së drejtorit të Zyrës së Këshilltarit ligjor;
     - z. Carl Campeau, zyrtar ligjor në Zyrën e Këshilltarit ligjor
   - Në emër të ankuesve:
     - z. Paul Troop, avokat, Tooks Chambers, Londër,
     - z. Jude Bunting, avokat, Tooks Chambers, Londër,
     - z. Halim Sylejmani, avokat, Prishtinë,
     - znjsh. Alexandra Channer, ndihmëse e z. Sylejmanit, Prishtinë.

   Ankuesit Kadri Balaj, Shaban Xheladini, Zenel Zeneli dhe Mustafa Nerjovaj gjithashtu kanë qenë të pranishëm.

5. Pas dëgjimit të palëve, në të njëjtën ditë Paneli vendosi të shtyjë seancën deri më 4 qershor 2009, kur seanca do të mbahej e hapur. Për shkak të informatës së pranuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), më 12 maj 2009, Paneli vendosi të anulojë seancën dëgjimore.

6. Më 31 mars 2010, Paneli shpalli ankesën si të papranueshme, duke marrë parasysh Urdhëresën administrative nr. 2009/1, të datës 17 tetor 2009 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut (shih §§ 32-34 më poshtë), të nxjerrë gjatë periudhës së procedurës. Në veçanti, Paneli konstatoi, se pjesët thelbësore të ankesës *prima facie* kanë pasur të bëjnë me fushëveprimin e Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta (shih § 35 më poshtë), dhe rrjedhimisht është konsideruar si e papranueshme. Më tej, Paneli vërejti se pjesët thelbësore dhe procedurale të ankesës kanë qenë të ndërlidhura në atë mënyrë sa që ndarja e tyre do të ishte artificiale. Për këtë arsye ka konsideruar se tërë ankesa është e papranueshme.

7. Në vendimin e tij, Paneli aplikoi Rregullën 49 të Rregullores së tij të punës, ku parashihet që çështjet që nuk rregullohen përmes kësaj Rregulloreje të punës të zgjidhen nga Paneli. Më tej, Paneli vendosi se pasi të jetë kryer Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta, ankuesit mund të kërkojnë rihapjen e procedurës. Paneli kishte theksuar se pastaj do të vendoste, në bazë të informatave në dispozicion, nëse duhet të pranojë atë kërkesë apo ta refuzojë atë.

8. Më 17 dhjetor 2010, ankuesit informuan Panelin për përfundimin e Procesit të OKB-së mbi kërkesat e palëve të treta lidhur me secilën prej tyre. Ata kërkuan nga Paneli që të vazhdojë me përpunimin e ankesës, ashtu siç i është parashtruar fillimisht Panelit, posaçërisht me pjesët procedurale të saj.

9. Më 23 dhjetor 2010, Paneli kërkoi informata të tjera nga ankuesit. Në të njëjtën datë ia komunikoi PSSP-së kërkesën për rihapjen e procedurave.

10. Përmes një letre elektronike (e-mail), të datës 22 gusht 2011, ankuesit dërguan parashtresat në mbështetje të kërkesës së tyre, që mbanin datën 8 gusht 2011. Përmes letrës së datës 12 shtator 2011, ata dërguan parashtresat e njëjta së bashku me një numër dokumentesh.

11. Më 19 shtator 2011, Paneli ia komunikoi PSSP-së parashtresat e ankuesve, me qëllim që UNMIK-u të jep mendimin rreth tyre. Paneli theksoi se veçanërisht kërkon të merr komente lidhur me një numër pyetjesh specifike.

12. Më 30 shtator 2011, Zyra për çështje ligjore e UNMIK-ut kërkoi qartësim lidhur me përfaqësimin nga avokati të ankuesve Zenel Zeneli dhe Mustafa Nerjovaj. Më 14 tetor 2011, Paneli ia përcolli këtë kërkesë avokatit të ankuesve. Avokati i ankuesve dërgoi përgjigjen më 14 tetor 2011. Autorizimet e nënshkruara nga dy ankuesit e lartcekur, të datës 25 tetor 2011, i janë dërguar Panelit më 10 nëntor 2011.

13. Më 21 nëntor 2011, PSSP-ja dha komentet e UNMIK-ut lidhur me parashtresat e ankuesve, por vetëm për ato që janë parashtruar në emër të Kadri Balajt dhe Shaban Xheladinit.

14. Më 28 nëntor 2011, Paneli ia komunikoi PSSP-së pranimin e letrave të autorizimit, të nënshkruara nga Zenel Zeneli dhe Mustafa Nerjovaj, dhe ftoi atë që të parashtrojë komentet shtesë sipas nevojës.

15. Më 5 dhjetor 2011, PSSP-ja dha komentet shtesë të UNMIK-ut lidhur me parashtresat e bëra në emër të Zenel Zenelit dhe Mustafa Nerjovajt.

16. Më 29 dhjetor 2011, Paneli ia komunikoi ankuesve të dy komentet e PSSP-së, dhe ftoi ata të parashtrojnë komente të tjera. Më 6 shkurt 2012, ankuesit dhanë përgjigjen e tyre.

17. Më 11 prill 2012, Paneli ia komunikoi PSSP-së përgjigjen e ankuesit, dhe ftoi atë të parashtrojë komente të tjera dhe të ofrojë disa dokumente. Më 9 maj 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

II. FAKTET

18. Ankesa e parashtruar fillimisht nga ankuesit ka të bëjë me veprimet e njësive policore, të formuara nga UNMIK-u nga pjesëtarë të vendeve të ndryshme, me rastin e protestave të organizuara nga Vetëvendosja në Prishtinë, më datën 10 shkurt 2007. Si rezultat i këtyre veprimeve, Mon Balaj, djali i ankuesit të parë,

dhe Arben Xheladini, djali i ankuesit të dytë, janë vrarë, ndërsa protestues të tjerë janë lënduar, ku disa prej tyre kanë marrë lëndim të rënda, duke përfshirë Zenel Zenelin dhe Mustafa Nerjovajn, ankuesin e tretë dhe të katërt.

19. Sa i përket pasqyrës së shkurtër të fakteve lidhur me këto ngjarje dhe hetimit pasues, Paneli i referohet vendimeve të tij të datës 6 qershor 2008 (§§ 1-3) dhe 31 mars 2010 (§§ 1-5). Në vijim paraqiten faktet lidhur me kërkesat e parashtruara në kuadër të kornizës së Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta (shih § 35 më poshtë).

20. Gjatë javëve pas ngjarjeve të 10 shkurtit 2007, UNMIK-u ftoi ankuesit që të parashtrojnë ankesa për kompensim. Të katër ankuesit parashtruan këto ankesa mes prillit dhe gushtit të vitit 2007. Këto ankesa u shqyrtuan nga Bordi i UNMIK-ut për kërkesa vendore. Sipas informatës së dhënë nga UNMIK-u, më 27 dhjetor 2007 rekomandimet për kompensim i janë përcjellë Bordit të selisë së OKB-së për shqyrtimin e ankesave.

21. Në vitin 2009, pas shqyrtimit fillestar i kërkesave për kompensim, Kontrolluesi i Kombeve të Bashkuara kërkoi nga UNMIK-u që shuma e kompensimit që do të duhej paguar të negociohet me ankuesit. Pas arritjes së marrëveshjes për shumën përfundimtare, kërkesat është dashur t'i parashtrohen Bordit të UNMIK-ut për kërkesat lokale.

22. Më 24 korrik 2009, PSSP-ja u takua me disa prej ankuesve. Sipas ankuesve, ai u kërkoi falje atyre për veprimet që kanë çuar në ngjarje tragjike. Pretendohet se ai ka përsëritur kërkimfaljen e tij gjatë takimit me ankuesit e tjerë, më 23 shtator 2009.

23. PSSP-ja ka krijuar një grup negociues me qëllim të arritjes së marrëveshjes me ankuesit. Më 14 gusht 2009, grupi negociues propozoi shuma domethënëse për kompensim të ankuesve Balaj, Xheladini dhe Zeneli. Gjatë diskutimit të shumave për kompensim janë mbajtur takime të ndryshme dhe janë këmbyer letra. Ankuesit gjithashtu kanë ngulmuar në faktin se edhe nëse pranojnë kompensimin, ata dëshironin t'i vazhdonin procedurat para Panelit. Më 25 shtator 2009, grupi negociues i njoftoi ankuesit Balaj dhe Xheladini se nëse pranojnë ofertën e dhënë, ata do të duhej të lironin UNMIK-un nga të gjitha përgjegjësitë. Më 2 tetor 2009, ankuesit Balaj dhe Xheladini u përgjigjen se ata jo vetëm që kërkojnë kompensim, por edhe mënyra të tjera të ligjore, veçanërisht hapjen e hetimeve penale. Kështu, ata konsideruan se pranimi i kompensimit nuk do të lironte Panelin nga vazhdimi i shqyrtimit të lëndës dhe nga rekomandimi i masave të mëtejme.

24. Më 17 tetor 2009, është nxjerrë Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1 (shih §§ 32-34 më poshtë).

25. Gjatë një takimi më 30 dhjetor 2009, ankuesit deklaruan se nuk dëshironin të lidhnin marrëveshje me UNMIK-un lidhur me çështjen e kompensimit. Më 4 janar 2010, grupi negociues i shkroi ankuesve Balaj, Xheladini dhe Zeneli, duke ofruar përsëri arsyetimin për shumat e propozuara, duke i ritheksuar ofertat e bëra dhe duke cekur se nëse ankuesit nuk do ta pranonin ofertën, UNMIK-u

prapëseprapë do të vazhdonte me procedurën e kompensimit. Mes ankuesve dhe UNMIK-ut nuk është arritur marrëveshja.

26. Më 31 mars 2010, Paneli shpalli ankesën si të papranueshme, duke ia lënë ankuesve mundësinë e hapur që të kërkojnë rihapjen e procedurave pas përfundimit të Procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta (shih §§ 6-7 më lartë).

27. Më 27 dhe 28 maj 2010, UNMIK-u njoftoi Arlinda Xheladinin, të venë e Arben Xheladinit, dhe Kadri Balajn, se ofertat për kompensim të aprovuara nga Bordi i UNMIK-ut për shqyrtimin e kërkesave lokale, ishin miratuar nga ndihmësi i Sekretarit të përgjithshëm (dhe nga Kontrolluesi) i Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. UNMIK-u ishte i gatshëm të paguante shumat e ofruara, me kusht të nënshkrimit nga ana e ankuesve të "formularit për lirim nga përgjegjësia". Formularët për lirim nga përgjegjësia përmbanin deklaratën vijuese: "Deklaroj se kjo ofertë është e plotë dhe përfundimtare për të gjitha kërkesat, të çfarëdo natyre dhe lloji qofshin, të cilat rezultojnë nga humbja e lartpërmendur" (duke iu referuar vdekjes së viktimës). Më 9 qershor 2010, Kadri Balaj dhe Arlinda Xheladini nënshkruan formularin për lirim nga përgjegjësia. Më 4 gusht 2010 atyre u është paguar kompensimi.

28. Më 21 qershor 2010, UNMIK-u shpalli miratimin e ofertës për Zenel Zenelin, dhe shprehu gatishmërinë e tij për pagesën e shumës së ofruar, me kusht të nënshkrimit të formularit për lirim nga përgjegjësia, ku përfshihej deklarata vijuese: "Deklaroj se kjo pagesë është e plotë dhe se paraqet shlyerjen përfundimtare të të gjitha kërkesave, të çfarëdo natyre dhe lloji, që rezultojnë nga dëmtimet e lartcekura." Zenel Zeneli ka nënshkruar formularin për lirim nga përgjegjësia më 22 qershor 2010. Më 23 qershor 2010, atij i është paguar kompensimi.

29. Më 1 nëntor 2010, grupi negociues propozoi kompensim substancial për Mustafa Nerjovajn. Grupi theksoi se kompensimi do të jetë "i plotë dhe do të jetë marrëveshje përfundimtare për të gjitha kërkesat që dalin nga lëndimet e datës 10 shkurt 2007".

30. Më 26 prill 2011, UNMIK-u shpalli miratimin e ofertës për Mustafa Nerjovajn me kusht të nënshkrimit të formularit për lirim nga përgjegjësia. Mustafa Nerjovaj nënshkroi formularin për lirim nga përgjegjësia më 28 prill 2011. Më 29 prill 2011 atij i është paguar kompensimi.

III. KËRKESA PËR RIHAPJEN E PROCEDURAVE TË PANELIT

31. Ankuesit kërkojnë rihapjen e procedurave të Panelit, në mënyrë që Paneli të mund të rifillojë shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës së tyre.

IV. KORNIZA RELEVANTE NORMATIVE

32. Nenet 2.1, 2.2 dhe 2.3 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1, të datës 17 tetor 2009 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, parashohin si në vijim:

> "2.1. Në cilëndo fazë të procedurës së ankesës për shkeljen e të drejtave të njeriut para tij, Paneli këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para shqyrtimit të bazueshmërisë së saj.
>
> 2.2. Cilado ankesë që i nënshtrohet Procesit apo proceduarës së OKB-së për kërkesat e palëve të treta ose që mund t'u nënshtrohet atyre në bazë të nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut, si dhe të punonjësve të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, konsiderohet e papranueshme për arsye se Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete juridike në dispozicion në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores nr. 2006/12).
>
> 2.3 Komentet për bazueshmërinë e shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut parashtrohen vetëm atëherë pasi që Paneli këshillëdhënës të ketë përfunduar shqyrtimin e ankesës dhe të ketë përcaktuar pranueshmërinë e saj. Nëse çështjet e pranueshmërisë së ankesës trajtohen kurdoherë pasi që Paneli këshillëdhënës të ketë marrë vendimin për pranueshmërinë e ankesës dhe të ketë filluar shqyrtimin e bazueshmërisë, Paneli këshillëdhënës pezullon shqyrtimin për bazueshmërinë deri në rivlerësimin e plotë të pranueshmërisë së ankesës dhe në marrjen e vendimit për të."

33. Neni 5 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 parasheh se asnjë ankesë në Panel nuk është e pranueshme "nëse pranohet nga Sekretaria e Panelit këshillëdhënës më vonë se më 31 mars 2010".

34. Neni 6 parasheh që Urdhëresa administrative nr. 2009/1 hyn në fuqi më 17 tetor 2009, e cila është edhe data e lëshimit të saj, dhe se "vlen për të gjitha ankesat e parashtruara tek Paneli këshillëdhënës, duke i përfshirë edhe ato që tani për tani janë në shqyrtim nga Paneli këshillëdhënës".

35. Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta, i cekur në nenin 2.2 është pjesë e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 52/247, të datës 17 korrik 1998 për "Përgjegjësinë e palës së tretë: kufizimet e përkohshme dhe financiare" (A/RES/52/247). Dispozitat relevante të asaj Rezolute parashohin si në vijim:

> "5. *Vendos* se kufizimet kohore dhe financiare, të parapara në paragrafët 8 deri në 11 më poshtë vlejnë vetëm për kërkesat e palëve të treta kundër Organizatës përkitazi me lëndimet, sëmundjen apo vdekjen, si dhe për humbjen a dëmtimin e pronës (duke përfshirë shfrytëzimin pa leje të objektit) që rezulton apo që i atribuohet aktiviteteve të pjesëtarëve të operacioneve paqeruajtëse gjatë

realizimit të detyrave të tyre zyrtare, ashtu siç janë përshkruar në paragrafin 13 të raportit të Sekretarit të përgjithshëm (A/51/903);

6. *Miraton* pikëpamjen e Sekretarit të përgjithshëm se përgjegjësia nuk përfshihet lidhur me kërkesat e palëve të treta që rezultojnë ose që u atribuohen aktiviteteve të pjesëtarëve të operacioneve paqeruajtëse dhe që rrjedhin nga 'nevojat operacionale', siç është përshkruan në paragrafin 14 të raportit të parë të Sekretarit të përgjithshëm për përgjegjësinë e palëve të treta (A/51/389);

7. *Gjithashtu miraton* pikëpamjet e Sekretarit të përgjithshëm, të pasqyruara në paragrafin 14 të raportit të tij (A/51/903), lidhur me kërkesat e palëve të treta që rezultojnë nga neglizhenca e madhe apo nga sjellja e qëllimshme e keqe e personelit të shteteve kontribouese të trupave për operacionet paqeruajtëse, si dhe kërkon nga ai që të raporton për zbatimin e tyre në kuadër të raporteve përkatëse të performancës;

8. *Vendos* që, në rastet kur kërkohet përgjegjësia e Organizatës lidhur me kërkesat e palëve të treta kundër Organizatës, të cilat rrjedhin nga operacionet paqeruajtëse, Organizata nuk do të paguajë kompensimin për ato kërkesa, të cilat parashtrohen gjashtë muaj pas ndodhjes së dëmit, lëndimit apo të humbjes, apo nga momenti kur kërkuesi ka kuptuar, dhe, në cilindo rast, pas një viti nga përfundimi i mandatit të operacionit paqeruajtës, me kusht që në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë ato të përshkruara në paragrafin 20 të raportit të Sekretarit të përgjithshëm (A/51/903), Sekretari i përgjithshëm mund të pranojë në shqyrtim kërkesën e bërë në një datë të mëvonshme;

9. *Po ashtu vendos*, lidhur me kërkesat e palëve të treta kundër Organizatës për lëndimin, sëmundjen apo vdekjen që rezulton nga operacionet paqeruajtëse:

(*a*) Përkitazi me llojet e kompensueshme të lëndimit apo të humbjes që kufizohen vetëm në humbjet ekonomike, siç janë shpenzimet mjekësore dhe të rehabilitimit, humbja e të ardhurave, humbja e përkrahjes financiare, shpenzimet e transportit lidhur me lëndimin, të sëmundjes apo të kujdesit shëndetësor, shpenzimet juridike dhe të varrimit;

(*b*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për humbjet joekonomike, siç janë dhimbja dhe vuajtja ose vuajtja morale, si dhe për dëmet e natyrës së ndëshkimit apo ato morale;

(*c*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për shërbimet e kujdesit në shtëpi dhe për dëmtimet e tjera të ngjashme, të cilat sipas mendimit të Sekretarit të përgjithshëm, janë të pamundshme të verifikohen apo që nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me lëndimin apo humbjen;

(*d*) Shuma e kompensimit të pagueshëm për lëndim, sëmundje apo vdekje të individit, duke përfshirë llojet e humbjeve apo të shpenzimeve të përshkruara në nënparagrafin (a) më lartë, nuk mund ta kalojë shumën prej 50 000 dollarë amerikanë, me kusht që në kuadër të këtij kufizimi, shuma aktuale të përcaktohet, duke iu referuar standardeve vendore të kompensimit;

(*e*) Në rrethana të jashtëzakonshme, Sekretari i përgjithshëm mund t'i rekomandojë për miratim Asamblesë së përgjithshme që

kufizimi prej 50 000 dollarësh, i paraparë në nënparagrafin (*d*) më lartë mund të tejkalohet për ndonjë rast të veçantë, nëse Sekretari i përgjithshëm, pas kryerjes së hetimit të nevojshëm, vjen në përfundim se ka arsye bindëse për tejkalimin e shumës së kufizuar;

10. *Gjithashtu vendos* përkitazi me kërkesat e palëve të treta kundër Organizatës që kanë të bëjnë me humbje të pronës apo me dëm që rezulton nga operacionet paqeruajtëse:

(*a*) Kompensimi për shfrytëzim të objekteve apo hapësirave pa leje: (i) llogaritet në bazë të vlerës së drejtë të qirasë, të përcaktuar në bazë të çmimeve të tregut vendor të qirave para ardhjes së operacionit paqeruajtës, të përcaktuar nga ekipi teknik i Kombeve të Bashkuara që vjen para ardhjes së misionit ose (ii) nuk tejkalon shumën maksimale, të pagueshme për metër katror apo për hektar, të përcaktuar nga ekipi për analizë teknike në bazë të informatave relevante në dispozicion; Sekretari i përgjithshëm do të vendosë për metodën e duhur të llogaritjes së kompensimit të pagueshëm për shfrytëzimin pa leje të objekteve apo hapësirave pas përfundimit të analizës teknike, e cila bëhet para ardhjes së misionit;

(*b*) Kompensim për humbje apo dëm ndaj objektit: (i) llogaritet në bazë të ekuivalentit të numrit të muajve të vlerës së qirasë apo në bazë të përqindjes fikse të shumës së qirasë, të pagueshme për periudhën e qëndrimit të Kombeve të Bashkuara; ose (ii) caktohet sipas përqindjes fikse të kostos së riparimit; Sekretari i përgjithshëm do të vendos për metodën e duhur të llogaritjes së kompensimit të pagueshëm për humbje apo dëm ndaj objektit pas përfundimit të analizës teknike para ardhjes së misionit;

(*c*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për humbje apo dëm, të cilat vetëm sipas mendimit të Sekretarit të përgjithshëm, janë të pamundshme të verifikohen apo nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me humbjen apo dëmin ndaj objektit;

11. *Vendos* që:

(*a*) Kompensimi për humbje apo dëm të pronës personale të palëve të treta që rrjedh si rezultat i aktiviteteve të operacioneve apo që ndërlidhet me kryerjen e detyrave zyrtare nga pjesëtarët e saj, mbulohet sipas kostos së arsyeshme të riparimit a të ndërrimit;

(*b*) Kombet e Bashkuara nuk paguajnë kompensim për humbjet a dëmet, të cilat vetëm sipas mendimit të Sekretarit të përgjithshëm janë të pamundshme të verifikohen apo nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me humbjen a dëmin ndaj pronës personale;

12. *Kërkon* nga Sekretari i përgjithshëm të ndërmerr masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Rezolute lidhur me marrëveshjet për statusin e forcave në përputhje me paragrafin 40 të raportit të tij (A/51/903);

13. *Gjithashtu kërkon* nga Sekretari i përgjithshëm që të sigurojë që termet e referencës të bordeve vendore të shqyrtimit të përfshijnë kufizimet kohore dhe financiare lidhur me përgjegjësinë e Organizatës, të parapara në paragrafët 8 deri në 11 më lartë, dhe që këto borde të mbështeten në këto kufizime kohore dhe financiare si bazë për juridiksionin edhe rekomandimet e tyre për kompensimin e kërkesave të palëve të treta ndaj Organizatës, të cilat rezultojnë nga operacionet e saj paqeruajtëse.”

36. Neni 7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, të datës 18 gusht 2000 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe punonjësve të tyre në Kosovë, i cekur në nenin 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1, parasheh:

> “Kërkesat e palëve të treta për humbje a dëmtim të pronës, si dhe për lëndim, sëmundje apo vdekje që rrjedhin ose që i atribuohen KFOR-it, UNMIK-ut apo punonjësve të tyre, dhe të cilat nuk janë rrjedhojë e “nevojës operacionale” të pranisë së tyre, zgjidhen nga komisionet për kërkesa, të themeluara nga KFOR-i dhe UNMIK-u, sipas mënyrës e cila do të përcaktohet.”

V. LIGJI

A. Përfaqësimi i ankuesve Zenel Zeneli dhe Mustafa Nerjovaj

1. Parashtresa e palëve

37. Në komentet e tij të datës 21 nëntor 2011, PSSP-ja thekson se parashtresat lidhur me kërkesën për rihapjen e procedurës, të datës 8 gusht 2011, janë bërë nga zotërinjtë Troop dhe Bunting në emër të katër ankuesve, por se i janë përcjellë Panelit përmes letrës së datës 12 shtator 2011, të nënshkruar nga z. Sylejmani, në cilësinë e tij të përfaqësuesit të familjes Balaj dhe të asaj Xheladini. Sipas PSSP-së, ishte evidente nga letërkëmbimi i mëparshëm me Panelin dhe nga letërkëmbimi i UNMIK-ut me përfaqësuesit e ankuesve se z. Sylejmani ishte përfaqësues vetëm i familjes Balaj dhe i asaj Xheladini, dhe jo i Zenel Zenelit dhe i Mustafa Nerjovajt. Ai thekson se nuk ka dëshmi se këta ankues të fundit kanë autorizuar plotësimin e parashtresave në emër të tyrin.

38. Në komentet e tij të datës 5 dhjetor 2011, PSSP-ja thekson letrat e nënshkruara nga Zenel Zeneli e Mustafa Nerjovaj më 25 tetor 2011, përmes të cilave ata autorizojnë z. Sylejmanin që të përfaqësojë interesat e tyre në procedurat para Panelit. PSSP-ja argumenton se këto autorizime nuk mund të konsiderohen që kanë efekt retrospektiv. Rrjedhimisht, kërkesa për rihapjen e procedurës duhet të konsiderohet se është plotësuar nga ankuesit Zeneli dhe Nerjovaj më 23 nëntor 2011, kur Paneli pranoi një letër nga z. Sylejmani, të datës 10 nëntor 2011, përmes së cilës u përcollën autorizimet e lartpërmendura.

39. Në komentet e tyre të datës 6 shkurt 2012, ankuesit shprehin habinë e tyre kur UNMIK-u kërkon të sugjerojë që përfaqësuesit e tyre ligjorë në fakt asnjëherë nuk kanë vepruar në emër të secilit prej tyre. Ata kategorikisht deklarojnë se që të katërt kanë udhëzuar z. Sylejmanin dhe zotërinjtë Troop dhe Bunting që të veprojnë në emër të tyrin në procedurat para Panelit. Ata japin disa shembuj të parashtresave të dërguara më parë, nga të cilat del se përfaqësuesit qartazi kanë vepruar në emër të të katër ankuesve.

2. Vlerësimi i Panelit

40. Paneli thekson se gjatë procedurave deri në momentin e kërkesës për rihapje të tyre, të gjithë katër ankuesit gjithmonë kanë qenë të përfaqësuar nga zotërinjtë Sylejmani, Troop dhe Bunting. UNMIK-u asnjëherë më parë nuk ka pasur ndonjë vërejtje lidhur me autorizimet e përfaqësuesve për të vepruar në emër të ankuesve Zeneli dhe Nerjovaj. Paneli gjithmonë ka konsideruar që përfaqësuesit veprojnë në emër të të katër ankuesve.

41. Është e vërtetë se autorizimet zyrtare janë nënshkruar tek më 25 tetor 2011, dhe janë pranuar nga Paneli më 23 nëntor 2011. Megjithatë, në këto letra ankuesit Zeneli dhe Nerjovaj shprehimisht cekin se ata miratojnë të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani nga avokatët e Took Chambers dhe nga z. Sylejmani në emër të tyrin. Paneli konsideron se këto letra janë të mjaftueshme për të vërtetuar autorizimet e përfaqësuesve të tyre dhe aftësinë e tyre për të përfaqësuar ankuesit

në procedurën para Panelit (Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), *Melnik kundër Ukrainës*, nr. 72286/01, aktgjykim i datës 28 mars 2006, § 57).

42. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se ankuesit Zeneli dhe Nerjovaj kanë qenë drejtësisht të përfaqësuar nga zotërinjtë Messrs Troop dhe Bunting, si dhe nga z. Sylejmani, me rastin e bashkimit të ankuesve të tjerë në kërkesën e tyre për rihapjen e procedurës, të parashtruar në Panel më 17 dhjetor 2010.

B. A ka përfunduar Procesi i KB-së për kërkesat e palëve të treta

43. Në bazë të nenit 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1, çfarëdo ankese "që është apo mund të bëhet në të ardhmen" pjesë e Procesit ose procedurave të KB-së për kërkesat e palëve të treta në bazë të nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 konsiderohet si e papranueshme.

44. Kjo dispozitë nuk përjashton shqyrtimin e ankesës që i nënshtrohet Procesit të KB-së për kërkesat e palëve të treta, pasi që procesi të ketë përfunduar.

45. Nuk vihet në pyetje se Procesi i KB-së për kërkesat e palëve të treta ka përfunduar në rastin e secilit prej ankuesve.

46. Mbetet të shihet nëse ka pengesë ligjore për rihapjen e procedurës së filluar nga ankuesit në vitin 2007. Në këtë drejtim, Paneli do t'i shqyrtojë vërejtjet e ngritura nga PSSP-ja në komentet e tij të datës 21 nëntor 2011 dhe 5 dhjetor 2011, si dhe çfarëdo vërejtje që mendon se duhet të ngritë në iniciativë të vet.

C. A ka pengesë ligjore për rihapjen e procedurës së Panelit

1. Mundësia për kërkimin e rihapjes së procedurës para Panelit pas datës së fundit të 31 marsit 2010

a) Parashtresat e palëve

47. PSSP-ja argumenton se nuk mund të parashtrohet ndonjë ankesë e re në Panel pas datës 31 mars 2010, datë kjo e fundit për parashtrimin e ankesave, e përcaktuar përmes nenit 5 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1. Sipas PSSP-së, nuk ka bazë për lejimin e rihapjes së procedurës pas kësaj date.

48. Paneli ka deklaruar në vendimin e vet të datës 31 mars 2010 se ankuesit kanë mundësinë e kërkimit të rihapjes së procedurës pas datës së fundit të 31 marsit 2010, PSSP-ja thekson se Paneli e ka bazuar atë vendim në Rregullën 49 të Rregullores së punës të Panelit. Rregulla 49 parasheh që çështjet që nuk rregullohen përmes Rregullores së punës zgjidhen nga Paneli. PSSP-ja argumenton se vetëm Rregullorja e punës nuk mund të krijojë procedurë të re, e cila nuk është e paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, përmes së cilës themelohet Paneli. Neni 18 i kësaj Rregulloreje parasheh që Paneli miraton rregulloren e punës. Megjithatë, PSSP-ja thotë se kjo dispozitë vetëm mund të kuptohet në formë të dhënies së kompetencës Panelit për miratimin e rregullores për procedurën e tij, siç parashihet në Rregullore dhe në urdhëresat administrative pasuese. Këtu nuk parashihet krijimi i një procedure të re që nuk është në

përputhje me frymën dhe qëllimin e Rregullores apo të urdhëresave administrative, të nxjerra sipas saj. Duke lejuar që kërkesa për rishqyrtim të parashtrohet pas datës përfundimtare, të paraparë në Urdhëresën administrative nr. 2009/1, Paneli morri qëndrimin që nuk është në përputhje me Urdhëresën administrative.

49. Ankuesit ftojnë Panelin që ta respektojë vendimin e vet të datës 31 mars 2010. Ata argumentojnë se nuk ekziston pengesa e papranueshmërisë apo e mosekzistimit të zotësisë juridike që do të pengonte shqyrtimin e plotë të rastit pas përfundimit të Procesit të KB-së për kërkesat e palëve të treta.

b) Vlerësimi i Panelit

50. Neni 5 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 parasheh që asnjë ankesë në Panel nuk do të jetë e pranueshme "nëse pranohet nga Sekretaria i Panelit këshillëdhënës më vonë se më datën 31 mars 2010".

51. Kjo dispozitë vlen për ankesat e reja. Për rastin në fjalë, ankuesit kërkojnë rihapjen e procedurës së filluar në vitin 2007.

52. Siç ka cekur Paneli në vendimin e vet të datës 31 mars 2010, përmes së cilit ankesa shpallej e papranueshme në bazë të nenit 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1 "efekti i shpalljes së papranueshmërisë për shkak të mosshterrimit të mjeteve juridike në dispozicion në parim është i natyrës së përkohshme dhe nuk është përfundimtar. Kjo do të thotë se ankuesi mund të riparashtrojë ankesën e tij pasi të jenë përfunduar të gjitha proceset e nevojshme" (§ 55). Më tej, Paneli mori parasysh ekzistimin e datës së fundit për ankesat e reja, dhe konsideroi se aplikimi strikt i nenit 5 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1 në rastin e ankuesve do të kishte efekte të papranueshme:

> "… nëse kërkohet që ankuesit të riparashtrojnë ankesën pas përfundimit të Procesit të KB-së për kërkesat e palëve të treta, atyre patjetër do t'u kalonte afati i fundit për parashtrimin e ankesave të reja, gjegjësisht data 31 mars 2010. Kushti për kalimin nëpër Procesin e KB-së për kërkesat e palëve të treta në këtë rast faktikisht do të shuante ankesën dhe nuk do t'ua linte mundësinë ankuesve për riparashtrim të saj në Panel, përkundër faktit se, siç ka konstatuar Paneli më 6 qershor 2008, ankesa ka qenë e pranueshme sipas kornizës rregullative, e cila ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të ankesës. Rrjedhimisht, një rezultat i tillë do t'i dëmtonte nocionet bazë të drejtësisë" (§ 57).

53. Paneli konfirmon këtë pikëpamje, dhe konstaton se pasi që Procesi për kërkesat e palëve të treta ka përfunduar, ankuesit mund të kërkojnë nga Paneli rihapjen e procedurës së filluar në vitin 2007, pa marrë parasysh faktin e fundit të datës 31 mars 2010, e cila paraqet pengesë për vazhdimin e shqyrtimit të ankesës së tyre.

54. Vërejtja e PSSP-së rrjedhimisht refuzohet.

2. Afati gjashtëmujor apo kushtet e tjera kohore

a) Parashtresat e palëve

55. PSSP-ja thotë se neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që Paneli mund të trajtojë çështjen vetëm "brenda periudhës gjashtëmujore nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar". Kjo do të thotë se çështja duhet të trajtohet brenda gjashtë muajve nga nxjerrja e vendimit përfundimtar sipas mënyrës së paraparë.

56. Për rastin në fjalë, sipas PSSP-së, "vendimi përfundimtar" është data e komunikimit nga Kontrolluesi i Kombeve të Bashkuara të marrëveshjes për pagesë të shumës së kompensimit të propozuar, të dakorduar mes palëve. Në rastin e Mon Balajt, vendimi i Kontrolluesit i është komunikuar familjes dhe përfaqësuesit të tyre ligjor më 28 maj 2010, ndërsa në rastin e Arben Xheladinit, vendimi është komunikuar më 27 maj 2010. Deri më 12 shtator 2011, ankuesit nuk kanë parashtruar kërkesën e tyre formale, të përcjellë me parashtresat e datës 8 gusht 2011. Kërkesa për rihapjen e lëndës, rrjedhimisht është dërguar më shumë se gjashtë muaj pas komunikimit të vendimit përfundimtar të Kontrolluesit dhe rrjedhimisht, nuk është e pranueshme. Në rastin e Zenel Zenelit, vendimi i Kontrolluesit është komunikuar më 21 qershor 2010, ndërsa në rastin e Mustafa Nerjovajt, më 26 prill 2011. Data efektive e parashtrimit të kërkesave të këtyre ankuesve për rihapje të procedurës është 23 nëntor 2011, gjegjësisht data e pranimit të letrave të tyre të datës 25 tetor 2011, përmes të cilave autorizohet z. Sylejmani që të veprojë në emër të tyre. Edhe në rastin e tyre, kërkesa për rihapjen e procedurës është dërguar më shumë se gjashtë muaj pas komunikimit të vendimit përfundimtar të Kontrolluesit dhe, rrjedhimisht, nuk është e pranueshme.

57. Ankuesit argumentojnë se "vendimi përfundimtar" nuk është data e komunikimit të "ofertës përfundimtare", e cila në rastet e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit ka qenë 28, përkatësisht 27 maj 2010. Kjo ofertë kërkonte pajtimin e ankuesve për të qenë e finalizuar. Ankuesit përkujtojnë se Kadri Balaj dhe Arlinda Xheladini kanë nënshkruar formularin për lirim nga përgjegjësia më 9 qershor 2010; se oferta përfundimtare i është dërguar Zenel Zenelit më 21 qershor 2010; se një ofertë i është dërguar Mustafa Nerjovajt më 1 nëntor 2010 dhe oferta përfundimtare i është dërguar më 26 prill 2011. Ankuesit argumentojnë se data kur ka përfunduar Procesi i KB-së për kërkesat e palëve të treta është data kur Kombet e Bashkuara ia kanë paguar kompensimin çdo ankuesi.

58. Ankuesit më tej thonë se kërkesa për rihapjen e procedurës është bërë më 17 dhjetor 2010. Kështu, kërkesa është parashtruar brenda gjashtë muajsh nga data kur Procesi i KB-së për kërkesat e palëve të treta ka përfunduar. Në fakt, para 18 qershorit 2010 (gjashtë muaj para 17 dhjetorit 2010) Kombet e Bashkuara nuk kishin pranuar formularët për lirim nga përgjegjësia nga të gjithë katër ankuesit dhe nuk kishin paguar kompensimin asnjërit prej ankuesve.

b) Vlerësimi i Panelit

59. Fillimisht, Paneli konstaton se afati kohor prej gjashtë muajsh, i paraparë në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 ka të bëjë me parashtrimin e ankesës.

Rregullorja nuk parasheh afat kohor për parashtrimin e kërkesës për rihapje të procedurës. Kjo nuk do të thotë se ankuesit pafundësisht mund të shtyjnë parashtrimin e asaj kërkese. Në të kundërtën, Paneli konsideron se ata duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm brenda kohës së arsyeshme.

60. Çka nënkupton "kohë të arsyeshme" duhet të përcaktohet për secilën rast, duke marrë parasysh rrethanat e caktuara të rastit.

61. Pika fillestare e llogaritjes së kohës së arsyeshme duhet të jetë data kur ka përfunduar Procesi i KB-së për kërkesat e palëve të treta, pasi që është ajo datë që paraqet fundin e mjetit juridik që ka ndaluar Panelin nga shqyrtimi i tij i vazhdueshëm i ankesës. Paneli konsideron se Procesi i KB-së për kërkesat e palëve të treta ka përfunduar për të gjithë ankuesit me kthimin e formularit për lirim nga përgjegjësia, të nënshkruar nga ta. Vet pagesa e kompensimit duhet të konsiderohet vetëm si ekzekutim i vendimit, të nxjerrë nga Kombet e Bashkuara, dhe nuk përbën një pikë nisjeje të mirë.

62. Paneli thekson se Kadri Balaj dhe Arlinda Xheladini kanë nënshkruar formularin për lirim nga përgjegjësia më 9 qershor 2010, Zenel Zeneli – më 22 qershor 2010, ndërsa Mustafa Nerjovaj – më 28 prill 2011.

63. Kërkesa për rihapjen e procedurave i është dërguar Panelit në emër të të katër ankuesve më datë 17 dhjetor 2010.

64. Paneli konsideron se nuk ka qenë e paarsyeshme që ankuesit të presin deri në përfundimin e Procesit të KB-së për kërkesat e palëve të treta për të katërtit. Duket se në një moment ata kanë vendosur që të mos presin më deri në përfundimin e procesit për ankuesin e katërt. Paneli konsideron se duke marrë parasysh rrethanat, ata kanë qenë brenda kohës së arsyeshme kur parashtruan kërkesën më 17 dhjetor 2010, brenda gjashtë muajve nga përfundimi i procesit për ankuesin e tretë dhe pak më shumë se gjashtë muaj që nga përfundimi i procesit për dy ankuesit e parë.

65. Rrjedhimisht, vërejtja e PSSP-së refuzohet.

3. Statusi i vazhdueshëm i ankuesit si viktimë

a) Parashtresat e palëve

66. PSSP-ja nuk paraqet ndonjë vërejtje lidhur me statusin e viktimës të ankuesve. Paneli konsideron se këtë duhet ta shqyrtojë në iniciativë të vet.

67. Ankuesit deklarojnë se vazhdojnë të kenë statusin e viktimës. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, ata veçanërisht argumentojnë se një vendim a masë e favorshme për aplikuesin në parim nuk është e mjaftueshme që ta privojë atë nga statusi i viktimës, përveç nëse autoritetet kompetente kanë pranuar, qoftë shprehimisht apo në esencë, dhe kanë ofruar mjet juridik për trajtimin e shkeljes së të drejtave të tij themelore.

68. Sipas ankuesve, kërkimfalja zyrtare dhe pranimi i përgjegjësisë nga PSSP-ja, si dhe pagesa e kompensimit janë pranim dhe zgjidhje e pamjaftueshme për shkeljet e të drejtave të tyre themelore, të pretenduara nga ankuesit, dhe nuk mund t'i privojnë ata nga statusi i viktimës. Ata konsiderojnë se të drejtat e tyre do të bëheshin iluzore dhe thjesht teorike, nëse UNMIK-u do të mund të parandalonte shqyrtimin e ankesave të tyre vetëm me pagesën e kompensimit. Kjo është e vërtetë sepse në njërën anë, Bordi i UNMIK-ut për shqyrtimin e kërkesave vendore (lexo: ekipi negociues) shprehimisht dhe në mënyrë të përsëritur ka deklaruar se kompensimi ka të bëje vetëm me humbjen ekonomike, ndërsa në anën tjetër, Procesi i KB-së për kërkesat e palëve të treta nuk ka marrë parasysh një numër çështjesh domethënëse që janë në thelb të rastit të ankuesve, siç është mënyra e duhur e hetimeve dhe mosekzistimi i ndjekjes penale. Me pranimin e kompensimit, ankuesit nuk kanë ndalur vullnetarisht hetimin e plotë të ankesave të tyre. Bordi i UNMIK-ut për shqyrtimin e kërkesave vendore ekziston vetëm për të administruar kompensimin dhe nuk ka aftësi të hetimit të ankesave apo të caktimit të përgjegjësisë. Ankuesit shtojnë se vazhdimisht kanë qenë të kujdesshëm për ta sqaruar se çfarëdo pranimi të kompensimit financiar ata e konsiderojnë si çështje të ndarë nga procedura para Panelit.

b) Vlerësimi i Panelit

69. Paneli pajtohet me ankuesit se vendimi apo masa e favorshme për ankuesin në parim nuk është e mjaftueshme që ai të privohet nga statusi i tij i "viktimës", përveç nëse autoritete kompetente kanë pranuar, qoftë shprehimisht apo në thelb, dhe më pastaj kanë dhënë mundësinë e shfrytëzimit të mjetit juridik për trajtimin e shkeljes së mekanizmave të të drejtave të njeriut, të cekur në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih, për autoritetet e fundit në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me dispozitat e "viktimës" në nenin 34 të KEDNj-së, GjEDNj (Dhoma e lartë), *Sakhnovskiy kundër Rusisë*, nr. 21272/03, aktgjykim i datës 2 nëntor 2010, § 67; GjEDNj (Dhoma e lartë), *Markin kundër Rusisë*, nr. 30078/06, aktgjykim i datës 22 mars 2012, § 82).

70. Për këtë rast, gjatë takimeve me familjarët PSSP-ja thuhet se ka kërkuar falje për veprimet që i atribuohen UNMIK-ut. Edhe pse ky është një hap domethënës, Paneli thekson se këto kërkime të faljes nuk janë bërë me shkrim.

71. Sido që të jetë, Paneli vëren se kompensimi i paguar ankuesve nuk është bazuar në çfarëdo pranimi të shkeljes së të drejtave të njeriut ndaj viktimave. Në fakt, kjo pagesë ka qenë *ex gratia*. Për më tepër, dhe siç u është shpjeguar vazhdimisht ankuesve nga ekipi negociues i UNMIK-ut, kompensimi kufizohet vetëm në humbjen ekonomike, duke përfshirë në veçanti humbjen e të ardhurave. Asnjë lloj kompensimi nuk paguhet për dhimbjen dhe vuajtjen morale, dëmet ndëshkuese ose morale apo për llojet e tjera të humbjeve, të cilat nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me lëndimin (shih Rezolutën 52/247 të Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 17 korrik 2008 për përgjegjësinë e palëve të treta, të cituar në § 35 më lartë, në § 9).

72. Posaçërisht, lidhur me ankesën për mungesën e hetimit të efektshëm të ngjarjeve të 10 shkurtit 2007, Paneli është i mendimit se detyra procedurale sipas nenit 2

dhe 3 të KEDNj-së nuk mund të konsiderohet se është plotësuar përmes pagesës së shumave të të hollave, si kompensim për dëmet materiale të pësuara nga viktimat dhe familjet e tyre (shih GjEDNj (Dhoma e lartë), *Al-Skeini kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 55721/07, aktgjykim i datës 7 korrik 2011, § 175).

73. Sipas nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, nga kjo del se ankuesit ende mund të thonë se janë viktima.

4. Lirimi nga përgjegjësia

a) Parashtresat e palëve

74. PSSP-ja argumenton se secili ankues ka nënshkruar formularin për lirim nga përgjegjësia me rastin e marrjes së kompensimit nga UNMIK-u. Formulari kishte formulimin vijues: "Deklarojë se kjo ofertë është e plotë dhe parqet zgjidhje përfundimtare të të gjitha kërkesave, të çfarëdo natyre dhe lloji qofshin, që rezultojnë nga si më lartë (vdekja apo lëndimet)." PSSP-ja konsideron se kjo paraqet lirim nga përgjegjësia për të gjitha kërkesat të çfarëdo lloji qofshin.

75. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, ankuesit thonë se për disa të drejta nuk mund të bëhet lirimi nga përgjegjësia dhe se lirimi nga përgjegjësia, për të qenë i vlefshëm, duhet t'i plotëson disa kushte. Në dritën e parimeve që rrjedhin nga praktika gjyqësore, ata konsiderojnë se nuk kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre përmes nënshkrimit të formularit për lirim nga përgjegjësia. E para, lidhur me të drejtat e përfshira në rastin e ankuesve, duke përfshirë ato të parapara në nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, nuk ka mundësi që njeriu të heq dorë prej tyre në asnjë rrethanë. Së dyti, asnjëra prej kushteve që duhet të plotësohen për lirim nga përgjegjësia nuk janë plotësuar në rastin e ankuesve: në asnjë moment ankuesit nuk janë sjellë në atë mënyrë, ku do të demonstrohej pajtimi i tyre i paluhatur për heqje dorë nga të drejtat e tyre, por në të kundërtën, ata vazhdimisht ia kanë bërë me dije UNMIK-ut qëllimin për ushtrimin e të drejtave të tyre pas përfundimit të Procesit të KB-së për kërkesat e palëve të treta; heqja dorë nga të drejtat themelore të ankuesve në rrethanat aktuale do të dëmtonte interesin jetik publik për t'u siguruar që shkeljet e të drejtave të njeriut të ankuesve, për të cilat ata ankohen, të dëgjohen nga Paneli, si dhe të ruhet llogaridhënia dhe besimi tek popullata; ka pasur garanca të pamjaftueshme lidhur me lirimin e pretenduar nga përgjegjësia që është në përputhje me natyrën themelore të të drejtave në fjalë; nuk mund të tregohet se ankuesit me arsye kanë paraparë se pasoja e nënshkrimit të formularëve për lirim nga përgjegjësia do të ishte heqja dorë nga të drejtat e tyre, duke marrë parasysh faktin se Bordi i UNMIK-ut për shqyrtimin e kërkesave vendore kishte informuar ankuesit se procesi i kompensimit nuk do të ndikonte në procedurën para Panelit dhe se formularët e lirimit nga përgjegjësia nuk përcaktojnë shprehimisht se rezultojnë në heqjen dorë nga të drejtat e ankuesve. Së treti, ankuesit nuk kanë nënshkruar formularët për lirim nga përgjegjësia pa shtrëngesë, pasi që atyre u është thënë nëse nuk nënshkruajnë formularët, ata nuk do të kompensohen. Së katërti, duke pasur parasysh kushtet e parapara në formularët për lirim nga përgjegjësia, si dhe qëllimin dhe të kuptuarit e ankuesve, nuk mund të konsiderohet se ata kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre; nuk ka referencë eksplicite në asnjërin prej formularëve të lirimit nga përgjegjësia

në ankesën para Panelit; referenca në "zgjidhjen e plotë dhe përfundimtare" të të gjitha kërkesave" duhet të interpretohet si instrument i ndjeshëm dhe i volitshëm për zgjidhjen e kërkesave financiare, dhe se rrjedhimisht nuk do të duhej të kishte efektin e privimit të cilësdo palë nga e drejta thelbësore, në këtë rast, e drejta për kërkimin e shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës për të drejta të njeriut para Panelit.

b) Vlerësimi i Panelit

76. Çështja në këtë rast është se nëse ankuesit përmes nënshkrimit të formularëve për lirim nga përgjegjësia, kanë hequr dorë nga shqyrtimi i ankesës së tyre nga Paneli, dhe më në përgjithësi, nga të drejtat themelore në të cilat thirren në ankesën e tyre.

77. Paneli nuk e konsideron të nevojshme shqyrtimin nëse nga këto të drejta mund të hiqet dorë. Për rastin në fjalë është e mjaftueshme të shqyrtohet nëse ka pasur heqje dorë të efektshme nga përgjegjësia.

78. Në këtë aspekt Paneli konsideron se në mënyrë që heqja dorë nga e drejta të jetë e efektshme, ajo duhet të përcaktohet pa mëdyshje dhe të përcjellët me masat minimale mbrojtëse në përputhje me rëndësinë e tyre (shih GjEDNj (Dhoma e lartë), *Sejdovic kundër Italisë*, nr. 56581/00, aktgjykimi i datës 1 mars 2006, § 86, *KEDNj*, 2006-II; GjEDNj, *Pishchalnikov kundër Rusisë*, nr. 7025/04, aktgjykim i datës 24 shtator 2009, § 77).

79. Për rastin në fjalë, PSSP-ja deklaron se heqja dorë rezulton nga nënshkrimi i ankuesve të formularit për heqje dorë, i cili përmban formulimin vijues: "Deklarojë se kjo ofertë është e plotë dhe paraqet zgjidhje përfundimtare të të gjitha kërkesave, të çfarëdo natyre dhe lloji qofshin, që rezultojnë nga si më lartë (vdekja apo lëndimet)."

80. Paneli vëren se kjo formulë i referohet "kërkesave" të çfarëdo natyre dhe lloji që rezultojnë nga vdekja apo nga lëndimet e viktimës. Një formulim i tillë duket mbulon vetëm kërkesat për kompensim. Sido që të jetë, nuk ka referencë eksplicite në ankesën e parashtruar në Panel.

81. Po kështu, duke marrë parasysh natyrën e ankesave të bëra nga ankuesit, Paneli konsideron se gjasat janë shumë të vogla se ata do të pranonin ofertën për kompensim që do të rezultonte me mosndëshkim të kryerësve të pretenduar të vrasjes dhe të plagosjes së viktimave (krahaso GjEDNj, *Pailot kundër Francës* dhe *Richard kundër Francës*, aktgjykimi i datës 22 prill 1998, *Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1998-II, përkatësisht § 52 dhe § 49). Për më tepër, ankuesit vazhdimisht ia kanë përsëritur UNMIK-ut qëllimin e tyre për të vazhduar me ankesën para Panelit pavarësisht çfarëdo dhënieje të kompensimit (shih, në mes të tjerash, letrat në emër të Kadri Balajt dhe Shaban Xheladinit, të datës 27 gusht 2009 dhe 2 tetor 2009). Po ashtu, në takimin e datës 30 dhjetor 2009, ata thanë se nuk ishin të përgatitur që të hynë në marrëveshje me UNMIK-un për shumën që duhej paguar, dhe UNMIK-u më pastaj vendosi të vazhdojë me procesin e kompensimit në bazë të asaj se nuk ka mundur të arrihej marrëveshja

(shih letrat e datës 4 janar 2010, të dërguara për ankuesit Balaj, Xheladini dhe Zeneli).

82. Paneli vjen në përfundim se, edhe nëse nënshkrimi i formularëve për lirim nga përgjegjësia nënkupton heqje dorë nga ana e ankuesve, nuk mund të konsiderohet se nënkupton heqje dorë pa dykuptimësi nga e drejta e tyre për marrjen e mendimit nga Paneli lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

83. Vërejtja e PSSP-së rrjedhimisht refuzohet.

5. Përfundim

84. Pasi erdhi në konstatim se nuk ka pengesa për rihapjen e procedurës, Paneli miraton kërkesën e ankuesve.

D. Fushëveprimi i procedurave të rihapura

a) Parashtresa e palëve

85. PSSP-ja argumenton se nëse Paneli vendos për rihapjen e procedurave, duhet të merr parasysh fushëveprimin e mandatit të tij. Në bazë të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/2, Paneli mund të shqyrtojë ankesa vetëm lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut nga UNMIK-u. Mandati i tij nuk shkon në shqyrtimin e akteve, lëshimeve apo vendimeve nga cilido organ tjetër i Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë ato të Asamblesë së Përgjithshme.

86. Më tej PSSP-ja thotë se një konsideratë e rëndësishme për Panelin do të duhej të ishte qëllimi specifik i ankuesve dhe çështjet që ata kanë kërkuar të shqyrtohen. Për rastin në fjalë, duket se kërkesa e ankuesve për rishqyrtim ka të bëjë vetëm me çështjet e hetimit penal, që do të mund të përcaktonte nëse vdekjet e datës 10 shkurt 2007 janë shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe që do të çonte në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës për këto vepra të paligjshme, pra, çështje brenda fushëveprimit të nenit 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Në këtë aspekt, PSSP-ja i referohet disa letrave, që ankuesit ia kanë dërguar UNMIK-ut në vitin 2009 dhe në letrën e tyre përkatëse drejtuar Panelit, të datës 17 dhjetor 2010.

87. Ankuesit deklarojnë se PSSP-ja gabimisht vlerëson se ata vetëm kërkojnë të përtërijnë ankesat e tyre sipas nenit 2 dhe të 3 të KEDNj-së. Ata qëndrojnë prapa çdo aspekti të ankesës së tyre, që ka të bëjë me të drejtën në jetë, të drejtën për të mos u torturuar (apo për të mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore a poshtëruese), të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për liri të grumbullimit dhe të drejtën për mjet të efektshëm juridik.

88. Më tej, ankuesit thonë se, derisa pagesa e kompensimit financiar mund të jetë relevante për çfarëdo rekomandimi që Paneli vendos ta bëjë lidhur me "justifikimin e drejtë", rekomandimi lidhur me hetimin e ligjshëm dhe publik për ankesat e tyre mbetet të jetë i rëndësisë primare personale për ta.

b) Vlerësimi i Panelit

89. Fillimisht, Paneli pranon se mandati i tij është i kufizuar në shqyrtimin e ankesave të drejtuara kundër UNMIK-ut lidhur me veprat dhe lëshimet që i atribuohen UNMIK-ut. Fushëveprimi i shqyrtimit të tij nuk ndryshon nga fakti se shqyrtimi i bazueshmërisë së ankesës pason pas kërkesës për rihapjen e procedurave.

90. Më tej, Paneli konsideron se ankuesit duhet të përcaktojnë fushëveprimin e kërkesës së tyre për rihapjen e procedurave: ata mund të kërkojnë nga Paneli që të vazhdojnë me shqyrtim qoftë të ankesës së tyre të plotë apo vetëm të ndonjë pjese të saj.

91. Për rastin në fjalë, ankuesit në kërkesën e tyre të datës 17 dhjetor 2010 shkruajnë:

> "Secili ankues dëshiron që Paneli të vazhdojë me shqyrtimin e ankesës, ashtu siç i është parashtruar fillimisht Panelit. Në veçanti, ankuesit do të dëshironin që Paneli të përqendrohet në ankesat rreth procedurave, të cilat kanë të bëjnë me çështjet, siç janë ankesat për shkeljet e aspekteve procedurale të së drejtës në jetë dhe të ndalimit të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues, si dhe në shkeljet e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të drejtës për mjet të efektshëm juridik. Këto nuk janë çështje që janë shqyrtuar në kuadër të Procesit të kërkesave të palëve të treta."

92. Paneli thekson se në fjalinë e parë ekziston referenca në ankesën, ashtu siç është paraqitur fillimisht në Panel, pra, në tërë ankesën. Në dy fjalitë pasuese, kemi ftesën për Panelin që të "përqendrohet" në pjesët specifike të ankesës, të cilave ankuesit u kushtojnë vëmendje të posaçme. Paneli nuk konsideron se ankuesit kanë për qëllim të kufizojnë kërkesën e tyre për rihapjen e procedurave ndaj këtyre pjesëve.

93. Ky interpretim vërtetohet nga leximi i parashtresave të ankuesve, të datës 8 gusht 2011, ku ata thonë se "faktet dhe çështjet e ngritura në ankesën e ankuesve kërkojnë vëmendje të mëtejme, posaçërisht duke marrë parasysh se aspektet themelore të kërkesës së tyre nuk kanë fituar kurrfarë vëmendje apo konsiderate gjatë Procesit të KB-së për kërkesat e palëve të treta" (§ 99), si dhe ftuan Panelin që "të rihapë kërkesën e (tyre) dhe që ta rishqyrtojë atë plotësisht" (§ 101).

94. Rrjedhimisht, Paneli do të vazhdojë me shqyrtim të bazueshmërisë së tërë ankesës, ashtu siç i është parashtruar ajo fillimisht.

95. Nuk ka nevojë që të saktësohet në këtë moment se deri në çfarë mase kompensimi financiar që i është paguar ankuesve ka pasur efekt në zgjidhjen juridike që do t'u ofrohet ankuesve në rast të përcaktimit të shkeljes të të drejtave themelore të viktimës. Kjo çështje, nëse ka nevojë, duhet të zgjidhet në fazën e bazueshmërisës së ankesës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

VENDOSË TË RIHAPË PROCEDURËN DHE TË VAZHDOJË ME SHQYRTIM TË BAZUESHMËRISË SË ANKESËS.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues